



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 1014 Prot

Datë 11 / 09 / 2022

NJOFTIM

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit nr. 90 dt.27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”; Vendimit nr 326, datë 31.05.2023 “Pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike”; Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”; Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së; shpall 1 (një) vend vakant në pozicionin e punës:

Punëtor Skene pranë Drejtorisë së Produksionit Skenik;

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme dhe kërkesat e veçanta si më poshtë:

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

- Të këtë arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional;
- Të njohë mirë teknikat e montimit, lëvizjet mekanike të gropës së skenës, zhvendosjen e ekulisave, shtangetave dhe çdo gjë tjetër që lidhet me mbarëvajtjen e punës në skenë;
- Të këtë njohuri profesionale si njohës i mirë i drurit (marangoz) apo mekanike si dhe profesione të tjera që ndihmojnë në kompetimin e tij si teknik në skenë;
- Të zbatojë rregullat e etikës në komunikimin me punonjësit e tjerë të TKOBAP (me eprorët dhe kolegët e tij) dhe të jetë i aftë të punojë në grup;

Adresa: “Sheshi Skënderbej” Tiranë

www.tkob.gov.al

-Të kryejë punën që i ngarkohet duke zbatuar me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë;

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

- 1.Jetëshkrimi CV;
- 2.Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;
- 3.Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 4.Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- 5.Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- 6.Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- 7.Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë së TKOBAP(zyra e protokollit) ose të skanuara në e-mailin zyrtar të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri me datë 13/10/2023.Pas verifikimit të dokumentave të kërkuara, në Teatrin Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara do të lajmërohen nepërmjet numrit të tyre të kontaktit ose mail nga Sekretaria e Institucionit për intervistën e strukturuar me gojë.

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të web-it të Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor www.tkob.gov.al; faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al.

DREJTORE e PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA

